


## RELACION HIDRO SANITAR

Ky objekt 2 katesh me funksion "Çerdhja nr.2", ndodhet ne Njesine Administrative nr.4, Rruga Jani Maçolli, Lagja Aqif Pasha, Elbasan.


Zona kadastrale nr.8524, Pasuria nr.7/646.

**Koordinatat gjeografike te objekti:506759.40, 4553706.65**




### **PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE**

Ambienti ndodhet në Njësinë Administrative Nr.4 ne Lagjen "Aqif Aasha " Rruga "Jani Maçolli", dhe është ndërtim i vjetër i ndërtuar para viteve 1945, dhe aktualisht shërben si çerdhe fëmijësh dhe konkretish e emërtuar Çerdhja Nr.2. Objekti është në gjendje funksionale dhe gjatë viteve në funksion ka pësuar rikonstruksione të vazhdueshme në zëra të veçantë por jo me ndërhyrje radikale ne mënyrë që të kishim një objekt të qendrueshëm përse i përket elementëve arkitektonikë. Objekti është me strukturë me muraturë tulle dhe i mbuluar me çati me tjegulla vendi me konstruksion druri, dhe nga jashtë është i pa suvatuar në tre ane të tij duke sjellë një degradim të fasadës.



*Çerdhja nr.2*

Objekti me funksion çerdhe me numër katesh 2 ku janë parashikuar zgjidhje funksionale per femijët që do e frekuentojnë atë. Janë parashikuar dy ambiente tualeti për femijë per secilin kat.



*Foto te gjendjes ekzistuese te tualeteve*

Nyjet higjenosanitare janë zgjidhur për t'iu përshtatur fëmijëve sipas kërkesave për çdo vit shkollor. Dyert e brendshme janë duro alumini te mbushura me duroalumin lisho sipas projektit të paraqitur. Per nyjet sanitare te objektit eshte parashikuar montimi i disa wc allafrenga importi per femije se bashku me instalimet hidrosanitare sipas kushteve teknike me materiale me bashkohore dhe duke

i përshtatur sipas projektit të paraqitur. Tualetet do të hidroizolohen totalisht, do të montohen instalimet e reja hidrosanitare për katin e përde dhe katin e përre teknik, do të mbushen me penobeton për shtrese të mbushjes 7 – 10 cm dhe do të kryhet h/izolimi i plote për të mos patur lageshtirë në tualete. Mbi këto shtrese do të shtrohen me pllaka gres porcelanatë të ratifikuara dhe lavamanë inkaso. Tualetet do të ndahen ndërmjet tyre me laminat fiber derrase kundër ujit dhe djegies. Në katin përde dhe të përre kemi 2 tualete për fëmijë për secilin kat ku në secilin një higjensanitare do të jenë 4 wc allafranga importi për fëmijë shoqëruar secila me një rubinet uji apo i quajtur ndryshe shataf (lares për higjienën personale të secilit fëmijë) dhe 4 lavamanë inkaso. Linjat kryesore të furnizimit do të jenë ato ekzistuese si dhe linjat e shkarkimit do të jenë të njëjta.

### **QËLLIMI I PROJEKTIT**

Nisur nga projekti arkitektonik u parashtrua se godina nuk plotëson standartet e nevojshme për tu frekuentuar nga fëmijet aktualisht, prandaj duhet të realizojmë një projekt për çerdhë i cili duhet të përmbushë standartet bashkohore për zhvillimin e orës mësimore si nga ana e organizimit funksional të ambienteve të brendshme por edhe nga ana e organizimit të hapësirave të jashtme por edhe nga ana e cilësisë të materialeve të përdorura në objekt. Ambjentet e tualetit duhet të jenë konform standardeve të projektimit të parashikuara. Për këtë arsye është parashikuar që shkarkimet e ujërave të zeza të behen në linjë ekzistuese të ndërtuara në katin përde. Kështu para përfundimit të punimeve duhet parashikuar që tubacioni për ujrat e zeza të pastrohen dhe të riparohen në ato segmente që do të futen në punë.

*Punoi: Ing. Bruno Korumi*



**DREJTORIA E PROJEKTIMIT**

**DREJTORI**

*ark. Marvis AVLLAZAGAJ*



**MIRATOI**

**KRYETARI BASHKISË**

**GLEDIAN LLATJA**

